



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

VENDIM

Nr. 452/1, datë 2.12.2021

**Mbi korrigjimin e gabimeve materiale në vendimin nr. 452, datë 24.9.2021 të
Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

Sot, më 2.12.2021, trupi gjykues, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Alma Faskaj	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare,

bazuar në nenin 112, të Kodit të Procedurave Administrative: “Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ”, sipas të cilit përcaktohet se:

“1. *Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
2. *Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij*”,

u mblodh për t’u njohur me kërkesën e relatores së çështjes, për korrigjimin e një gabimi material në vendimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Semiramis Hoxholli, me nr. 452, datë 24.9.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit:

1. Në fletën nr. 2, “I. RRETHANAT E ÇËSHTJES, pika 1, paragrafi 1, *Subjekti i rivlerësimit Semiramis Hoxholli, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, ex officio, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 16.12.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”*

Në këtë paragraf data e hedhjes së shortit është shkruar gabimisht **16.12.2019** dhe ky është një lapsus pasi data e hedhjes së shortit është **15.6.2020**.

2. Në pikën “(A) RIVLERËSIMI I PASURISË, *Konkluzion përfundimtar për kriterin e pasurisë, në paragrafin (iv) Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. I. J., ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016*”.

Në këtë paragraf, duhet të korrigjohet emri i subjektit të rivlerësimit, i cili rezulton të jetë një lapsus.

Konkretisht, emri i subjektit të rivlerësimit **z. I. J.** të zëvendësohet me emrin e subjektit të rivlerësimit **znj. Semiramis Hoxholli**.

Pas verifikimit, u konstatua se kërkesa e relatores qëndron, pasi vendimi nr. 452, datë 24.9.2021 i Komisionit i referohet subjektit të rivlerësimit znj. Semiramis Hoxholli dhe pasaktësia është dukshëm si pasojë e një gabimi material.

Për këto arsye, trupi gjykues,

V E N D O S I:

1. Korrigjimin e një gabimi material në fletën nr. 2, “I. RRETHANAT E ÇËSHTJES, pika 1, paragrafi 1, *Subjekti i rivlerësimit Semiramis Hoxholli, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, ex officio, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 16.12.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, ku data 16.12.2019 korrigjohet dhe të zëvendësohet me datën 15.6.2020, si edhe në pikën “(A) RIVLERËSIMI I PASURISË, Konkluzion përfundimtar për kriterin e pasurisë, në paragrafin (iv) Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. I. J., ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016”, ku emri i subjektit të rivlerësimit z. I. J. të korrigjohet dhe të zëvendësohet me emrin e subjektit të rivlerësimit **znj. Semiramis Hoxholli.***
2. Të njoftohet subjekti i rivlerësimit, Komisioneri Publik dhe Vëzhguesi Ndërkombëtar për këtë vendim korrigjimi.
3. Vendimi i korrigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Etleda ÇIFTJA
Kryesues

Suela ZHEGU
Anëtar

Alma FASKAJ
Relator

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta